



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr. 651 /2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 28/2008 nenit 40, Ligji për Miniera dhe Minerale Nr.03/L-163, Udhëzimin Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativë Nr.41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 32.5, Rregulloren për Taksa dhe Tarifa dhe Ngarkesa Administrative neni 13, Rregullores për Punë të Kuvendit nenit 15, shkresës përcjellëse me numër 02/Nr.651/2012 të datës 30.01.2012, procesverbalin e komisionit të datës 26.12.2011, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur më datë: 30.01.2012 mori:

V E N D I M

P Ë R

NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS DHE EKSPLOATIM TË MINIERËS SË MERGELËS

I

I jepet pëlqimi Ndërmarrjes Sharr Cem sh.p.k për ndërrim të destimit të pronës dhe eksploatimin në minierën e mergelës, parcelat që do të bëhet ndërrim destinimi dhe eksploatimi i mergelës gjendet në zonën kadastrale Hani i Elezit në emër të Sharr Cem sh.p.k qira mbajtje për 99 vite në sipërfaqe 40816 m², parcela me numër Nr.61-6 e cila është në emër të pronarit Sharr Cem sh.p.k e cila ka një sipërfaqe 1210 m², parcelat që do të bëhet ndërrim destinimi dhe eksploatimi i mergelës që gjendet në zonën kadastrale Dimcë në emër të Sharr Cem sh.p.k qira mbajtje për 99 vite ka sipërfaqe 132403 m², parcelat në emër të pronarit Sharr Cem sh.p.k ka sipërfaqe 97106 m² (numri i parcelave është i evidentuar në raportin e komisionit të datës 26.12.2011).

II

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit, ndërsa do të zbatohet pas pagesës së përcaktuar në bazë të Udhëzimit Administrativë Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativë Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

III

Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.

IV

Ndërmarrja e re Sharr Cem sh.p.k obligohet në afat ligjor (brenda dy viteve) që t'i filloj punimet në të kundërtën do të shfuqizohet vendimi i dhënë nga Kuvendi i Komunës. Pas përfundimit të eksploatimit të lëndës së parë obligohet ndërmarrja të bëjë rehabilitimin e të gjitha pronave.

V

Më këtë Vendim njoftohen: Pala, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Këshilla juridike: pala e pa kënaqur ka drejtë të paraqes ankesë në Gjykatë në afat prej 8 (tetë) ditëve nga pranimi i këtij vendimi.

Hani i Elezit
Data: 01.02.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlasi

